



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2949/1 prot.

Tiranë më 14.11.2025

Lënda: Mendim mbi një projektligj

ZNJ. ADEA PIRDENI
MINISTËR I SHTETIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE
ANTI-KORRUPSIONIN

Tiranë

E nderuar Znj.Ministre,

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj me nr. 5585/1 prot., datë 11.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 2949 prot., datë 13.11.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim paketën e projektligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Nga shqyrtimi i këtyre dokumenteve konstatojmë se ky projektligj synon përmirësimin dhe forcimin e kuadrit ligjor shqiptar por njëkohësisht dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e Bashkimit Evropian, në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, vërejmë se projektligji ka parashikuar në mënyrë specifike respektimin dhe garantimin e parimeve dhe rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, projektligji është hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi